

## Rakordim i të ardhurave të marra nga renta minerare nga Bashkia Patos dhe administrimi i fondeve në dobi të komunitetit në vitin 2012

---

Bashkia Patos





## Përmbajtje

### Përmbledhje Ekzekutive

Bashkia Patos

Komuna rreth zonës Patos

Gjeografia

Demografia

Kultura dhe Sporti

### Ekonomia

Buxheti

Renta Minerare

Legjislacioni

a. Ligje për rentën minerare

b. Udhëzime te Ministrisë Financave

c. Përqindja e rentës sipas klasifikimit për Sektorin Hidrokarbur

Kontributi industrisë nxjerrëse në ekonominë shqiptare

Kontributi i rentës minerare nga zonat industrisë nxjerrëse

**Kontrolli i përdorimit të fondeve të përfituara nga renta minerare**

### Konkluzione

### Rekomandime

### Tabela 1

Krahasimi i fondit buxhetor të qeverisjes vendore me fondet e dhëna nga renta minerare

### Tabela 2

Njësitë vendore përfituese të rentës minerare në vitet 2012 - 2013


### Tabela 3

Informacione dhe të dhëna të raportuara nga Bashkia Patos

### Tabela 4

Informacione dhe të dhëna të raportuara nga Komuna Mbrostar

Sekretariati Shqiptar EITI



Në zbatim të detyrave të dala në mbledhjen e MSG dhe të Urdhërit nr. 63, datë 23.03.2015 të Sekretariatit Shqiptar EITI, për ngritje grupi pune me objekt “Rakordimi i të ardhurave të marra nga renta minerare nga Bashkia Patos dhe administrimi i fondeve në dobi të komunitetit për vitin 2012”, është ndjekur dhe realizuar grumbullimi dhe përpunimi i informacionit të nevojshëm ekonomik – financiar dhe mbështetja ligjore nga strukturat shtetërore të ngarkuara me shpërndarjen dhe përdorimin e të ardhurave financiare e buxhetore nga renta minerare për qeverisjen vendore në rastin konkret në Bashkinë Patos.

## Metodologjia dhe puna përgatitore

Realizimi i detyrës së ngarkuar nga MSG është bërë në përputhje me kompetencat që ka EITI Shqiptar duke grumbulluar dhe përpunuar të dhënat e informacionet zyrtare për rakordimin e të ardhurave të marra nga fondi i rentës minerare dhe administrimin e këtyre fondeve të shpërndara për vitin 2012 në Bashkinë Patos.

Objektivi kryesor i këtij materiali është verifikimi i procesit të shpërndarjes së fondeve të rentës minerare për përfituesit dhe administrimin e këtyre fondeve në dobi të komunitetit, me qëllim që raportet e ardhshme EITI të përfshihen të dhëna jo vetëm për grumbullimin por edhe për shpërndarjen dhe përdorimin e këtyre fondeve në dobi të komunitetit të zonave të industrisë nxjerrëse.

Objektivi i punës ishte përgatitja e një raporti i cili do të informonte MSG dhe grupe të tjera të interesuar me tregues jo vetëm ekonomike për zonën përkatëse të Patosit, me qëllim për të evidentuar shpërndarjen dhe përdorimin e fondeve të rentës minerare në dobi të komunitetit në një zonë të caktuar. Në bazë të rrethanave janë :

- Mbledhur informacione të ndryshme dhe të nevojshme në lidhje me zonën hidrokarbure të Bashkisë Patos.

- Identifikuar fondet e rentës minerare të grumbulluara dhe të shpërndara nga Ministria e Financave në bazë të projekteve të paraqitura në përgjithësi dhe në veçanti për Bashkinë Patos.

- Verifikuar në terren administrimi i bërë për fondet e krijuara nga renta minerare dhënë për Bashkinë Patos bazuar në procedurat ligjore, rregullat dhe projektet përkatëse të miratuara dhe në dobi të komunitetit të zonës.

- Kontaktuar me drejtues dhe specialistë të NJQV si dhe me persona të komunitetit lidhur me përdorimin e përfitimin prej këtyre fondeve.

- Identifikuar kërkesa për përmirësime të mundshme në të ardhmen lidhur me aspektin legjislativ, procedurat e shpërndarjes së fondit të rentës minerare dhe të bashkëpunimit mes NJQV dhe agjencive shtetërore të lidhura me procesin EITI.

Për sa më sipër është zhvilluar takim me Kryetaren e Bashkisë Patos, znj. Rajmonda Balilaj, Shefen e Sektorit të Financave, znj. Mimoza Shtëmbari, Specialistin e Projekteve dhe Urbanistikës z. Andon Kristo, etj.

ku me të cilët është prezantuar qëllimi i vizitës dhe i është kërkuar informacion në lidhje me fondet e transferuara në formën e të ardhurave nga renta minerare e arkëtuar nga subjektet operatore në territorin e Bashkisë Patos për vitin 2012-2013, fondet respective, destinacioni i përdorimit të tyre, si dhe procedurat e ndjekura në zbatim të përdorimit. Në trajtimin dhe diskutimet e bëra me drejtues të njësisë vendore të Bashkisë Patos është prezantuar destinacioni i përdorimit të këtyre fondeve, ku ka qënë përmirësimi dhe rehabilitimi i infrastrukturës së zones, kryesisht në rrugë por edhe në çerdhe etj. Gjithashtu janë diskutuar edhe problemet e dala apo kërkesa për bashkëpunime në prespektivë. Takime e diskutime të lira janë zhvilluar edhe me banorë dhe kalimtarë në rrugët e reja të rikonstruktura në Bashkinë Patos me fondet e dhëna.

## PËRMBLEDHJE EKZEKURIVE

### Bashkia Patos

Bashkia e re e Patosit kufizohet në veri dhe në perëndim me bashkinë Fier, në jug me bashkinë Mallakastër dhe në lindje me bashkinë Roskovec. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Patosi. Qyteti i Patosit përfshihet në rrethin e Fierit. Ai është qyteti i dytë më i madh pas Fierit, për nga numri i banorëve, në Qarkun e Fierit.

Qyteti i Patosit ndodhet në juglindje të qytetit të Fierit, në rrugën kombëtare Fier-Tepelenë. Një Qytezë industriale e krijuar rreth vitit 1949 për të strehuar punëtorët dhe inxhinierët që punësoheshin në të quajturën "zona Patos-Marinëz" (një nga zonat më të pasura me naftë të Shqipërisë). Patosi është kryeqendra e industrisë së nxjerrjes së naftës në Shqipëri.

Kjo bashki përbëhet nga 3 njësi administrative, të cilat janë: Patos, Zharrëz dhe Ruzhdië. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Fierit dhe qarkut Fier. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 18 fshatra.

**Qyteti Patos**, Fshatrat: Rërez – Dukas – Kuqar – Rusinje – Margëlliç – Griz – Banaj

#### Njësi administrative:

**Zharrëz**, Fshatrat: Zharrëz, Fshat i Ri, Frashër, Verbas, Sheqishtë, Belinë Ruzhdië, Fshatrat: Ruzhdië, Siqecë, Gjynahqarë, Drenie, Kasnicë Cakran - Dërmenas - Frakull - Kuman - Kurjan - Levan - Libofshë - Mbrostar - Portëz - Qendër - Ruzhdië - Strum - Topojë - Zharrëz

## Gjeografia

Patosi ndodhet 7 km në jugperëndim të qytetit të Fierit i shtrirë përgjatë vargut kodrinor cili ndan Fushën e Myzeqesë nga luginë e lumit Gjanica. Ky varg kodrinor vazhdon në formë harku përgjatë rrugës Patos-Fier duke përngjarë me një amfiteatër natyror. Ai është pjesë e kodrave të Mallakastrës së poshtme të cilat vazhdojnë drejt Jugut deri në lumin Vjosë.

Lartësia mesatare e tyre është rreth 200-300 m e cila vjen duke u ulur drejt Patosit derisa zhyten në fushën e Myzeqesë. Pika më e lartë e rajonit ndodhet në kodrën e Margëlliçit me kuote 320 m mbi nivelin e detit. Përpara qytetit drejt veriut dhe veri-perëndimit shtrihet fusha e Myzeqesë ndërsa drejt veri-lindjes fusha e Roskovecit.



Sipërfaqja sipas relievit ndahet në: Fushore 718 ha dhe Kodrinore 1488 ha. Pranë qytetit degëzohen rruga Fier-Gjirokastrë dhe Fier-Berat të cilat kanë ndikuar në shtrirjen dhe zhvillimin e rajonit. Klima është tipike mesdhetare, me dimër të butë dhe të lagësht dhe verë të nxehtë e të thatë. Kjo situatë ndikohet nga masat ajrore detare për shkak të distancës relativisht të shkurtër nga deti Adriatik (rreth 25 km).

Nga ana lindore dhe jugore, vargmalet e larta e pengojnë depërtimin e klimës së ftohtë kontinentale. Temperatura mesatare vjetore luhet në 14-15 °C ndërsa temperatura e Janarit rreth 5 °C. Reshjet bien kryesisht në formë shiu ndërsa dëbora është dukuri e rrallë



Gjatë verës bien vetëm 1/10 e reshjeve vjetore gjë që shtrun nevojën e ujitjes së tokave bujqësore. Për këtë arsye janë ndërtuar disa liqene artificiale si ujëmbledhësi i Zharrzës, Lalarit, Rozhdies etj.

**Sipërfaqja :** 82.55 km<sup>2</sup>

## Demografia

**Popullsia** Zona: 42,738 banorë (Burimi:Gjendja Civile)

**Popullsia** Bashkia : 22,959 banore

Qyteti i Patosit ka 22,959 banorë. (Burimi:INSTAT)

Sipas Censurit të vitit 2011 bashkia e re Patos ka një numër prej 22.959 banorësh ndërsa në regjistrin civil rezultojnë 42.738 banorë. Territori i bashkisë së re është vetëm 82.5 km<sup>2</sup>. Në bazë të të dhënave të regjistrit civil densiteti i popullsisë është 518 banorë për km<sup>2</sup> ndërsa në bazë të censurit densiteti i popullsisë është 278.3 banorë për km<sup>2</sup>.

Përbërja e popullsisë së Patosit është heterogjene, të ardhur nga krahina të ndryshme të Shqipërisë si: Skrapari, Labëria, komuniteti Çam, të ardhur nga krahinat e komunitetit Vlleh, nga Minoriteti etj.

## Kultura dhe Sporti

Skuadra e futbollit e qytetit quhet "Albpetrol", e cila arritjen më të mirë ka daljen në finalen e kupës së Shqipërisë me skuadrën "Partizani" në sezonin 93'- 94', si dhe pjesëmarrjen në kupën e kupave të Evropës në sezonin 94'- 95'.

## EKONOMIA

Qyteza e Patosit nisi të ndërtohej rreth vitit 1949 për të strehuar punëtorët dhe inxhinierët e naftës. Baseni naftëmbajtës i njohur si "Patos-Marinza" është historikisht zona më e pasur me naftë në Shqipëri dhe sot vijon të prodhojë shumicën dërrmuese të naftës bruto në vendin tonë. Por pavarësisht kësaj, numri i të punësuarve në industrinë e naftës nga kjo zonë është sot shumë herë më i ulët se sa ka qenë dikur.

Për shumë vite burimi kryesor ekonomik ka qenë sektori naftënxjerrës. Por pasi kompanitë e huaja kanë nisur operimin në tregun e naftës niveli i të punësuarve në këtë sektor ka ndryshuar, duke sjellë një përqendrim gjithnjë e më të madh tek sektori i bujqësisë dhe agrikulturë. Sipas të dhënave tashmë, përveç ish komunës Zharrës, zonat e tjera si Patosi dhe Ruzhdia kanë si burim kryesor ekonomik kultivimin e ullirit dhe tregtimin e nënprodukteve të tij, të cilat favorizohen dhe nga vetë relievi kodrinor i kësaj zone.

Më tej është sektori privat i shërbimeve ai që siguron të ardhurat për zonën urbane dhe vitet e fundit kanë nisur aktivitetin në këtë njësi vendore edhe bizneset fasone. Për shkak të relievit malor, në këtë bashki ka zona të largëta nga qendra e bashkisë. Popullsia e tyre është reduktuar ndjeshëm për shkak të zhvendosjes drejt qendrave urbane të vendit ose drejt vendeve fqinje. Vitet e fundit, infrastruktura rrugore e zonës urbane dhe fshatrave përreth është përmirësuar ndjeshëm, por sigurisht ka ende shumë punë për t'u bërë në mënyrë që të sigurohet transporti sa më i lehtë i zonave të largëta malore drejt qendrës së bashkisë.

Shtrirja gjeografike e Patosit dhe zgjerimi i kësaj njësie vendore sigurisht që i bën më të mëdha sfidat për pushtetin vendor - bashkinë, duke gërshetuar nevojën për përmbushjen e problematikave të qytetit të Ballshit dhe atyre të zonave rurale përreth tij. Një nga problemet kryesore të identifikuara më shpesh nga banorët e kësaj zone lidhet me mbështetjen nga ana e bashkisë së kushteve për tregtimin e produkteve të tyre, kryesisht ullirit dhe vajit të ullirit. Promovimi i këtyre produkteve karakteristike për zonën, sigurisht që do të bënte që edhe sipërfaqet e mbjella të shtoheshin, por edhe ekonomia do të rritej. Një ndër sfidat më të rëndësishme me të cilat përballlet qeverisja vendore është dhe pastrimi dhe rehabilitimi i shumë nga zonave të braktisura naftënxjerrëse, si dhe marrja e masave për parandalimin e ndotjeve nga pushtet ekzistues.



Në këtë kuadër, banorët e kësaj bashkie kanë identifikuar si sfidë dhe rolin më të mirë bashkërendues të marrëdhënieve mes pushtetit vendor dhe kompanisë koncesionare që shfrytëzon fushën naftëmbajtëse.

Gjithashtu, një sfidë tjetër me të cilën do të përballlet qeverisja vendore - bashkia është lëvrimi nga pushteti qendror dhe miradministrimi i rentës minerare nga nxjerrja e naftës në këtë zonë, nga të cilat bashkia mund të sigurojë të ardhura prej miliona eurosh. Transparenca dhe mirëmenaxhimi i këtyre të ardhurave shërbejnë si një mekanizëm për përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve të kësaj bashkie.

Një ndër sfidat e tjera të identifikuara nga komuniteti i kësaj zone lidhet me ngritjen dhe përmirësimin e infrastrukturës së godinave arsimore të zonës, çerdhe, kopshte dhe shkolla, të cilat do të ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së arsimit në zonë.

Një aspekt tjetër që kërkon vëmendjen e pushtetit vendor është dhe rritja e numrit të familjeve të pastreha gjatë viteve të fundit, në mbështetje të të cilave duhen parashikuar dhe ndërtuar banesa sociale.

## Buxheti

v. 2012 është 80,312 mije leke

v. 2013 është 71,477 mije leke

v. 2014 është 84,876 mije leke

v. 2015 është 89,119 mije leke

**Burimi:** Ligji për buxhetin e shtetit sipas viteve 2012, 2013, 2014 dhe 2015

Masa të marra për uljen e shpenzimeve administrative :


- Reduktim i shpenzimeve administrative (paga dhe të tjera operative) me rreth 58 milionë lekë ose 13% e shpenzimeve totale të kryera nga të gjitha njësitë.

- Ulje e shpenzimeve të pagave nga 4460 në 3094 lekë për banor në njësinë e re (nga 176 milionë në 122 milionë në vit)

Rritje e buxhetit të investimeve nga 163 milionë lekë në vit në 221 milionë lekë në vit ose 36% rritje të buxhetit vjetor për investime. Rritje e investimeve për frymë nga 4130 lekë në 5608 lekë në njësinë e re.

**Burimi:**

<http://gis.ceshtjetvendore.gov.al/>



Pagesa e rentës minerare bëhet brënda datës 15 të muajit pasardhës, kur janë realizuar shitjet. Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brënda vendit.

## Legjislacioni

### a. Legjislacioni për rentën minerare

Në ligjin nr. 10487, datë 5.12.2011

“ Për buxhetin e vitit 2012” ( Aneksi 1,

Renta minerare), për rentën minerare që llogaritet sipas niveleve të caktuara në ligjin “ Për Taksat Kombëtare“ (neni 4,pika 4), është përcaktuar që 25 % e të ardhurave nga renta minerare i kalojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria dhe do të shpërndahet sipas kërkesës së tyre duke marrë parasysh klauzolat e lidhura me realizimin e buxhetit të pakushtëzuar. Ndërkohë, në nenin 15, të ligjit nr. 10487, datë 5.12.2011, “Për buxhetin e vitit 2012”,

## Renta Minerare

Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në rastin kur ai shet produkte minerare. Në rastin e eksportit të produkteve minerare, renta paguhet në çastin e bërjes së deklaratës së eksportit. Një pjesë e caktuar në % e të ardhurave nga renta minerare i kalojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria.

Renta minerare përcaktohet duke shumëzuar vlerën e përgjithshme të shitjes me shumicë të produktit me përqindjen e rentës, sipas përcaktimeve të shtojcës, që i bashkëlidhet ligjit Nr. 10280, datë 20.5.2010

pjesa e të ardhurave nga renta minerare që u takon njërive të qeverisjes vendore shpërndahet nga Ministria e Financave, sipas kërkesave të njërive të qeverisjes vendore, në përputhje me procedurat ligjore dhe formulës së përcaktuar në këtë ligj. Këto dy klauzola kanë vijuar edhe në ligjet përkatëse të viteve pasardhëse.

Në ligjin nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013” ( Aneksi 1, Renta minerare ), për rentën minerare që llogaritet sipas niveleve të caktuara në ligjin “ Për Taksat Kombëtare “, është përcaktuar që renta minerare që shkon për njësitë e qeverisjes vendore ( niveli ligjor maksimal i vlerësuar është 25 % e rentës së grumbulluar) do të shpërndahet sipas kërkesës së tyre dhe duke marrë parasysh klauzolat e lidhura me realizimin e buxhetit të pakushtëzuar. Në këtë vit është përcaktuar se NJQV do të përfitojnë + 50 % rentë minerare mbi transfertën ( buxhetin ) e pakushtëzuar pasi transfertat ( buxheti ) dhe renta të jenë barazuar.

Në ligjin nr. 185/2013, datë 02.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014” (Aneksi 1, Renta minerare ), për rentën minerare që llogaritet sipas niveleve të caktuara në ligjin “ Për Taksat Kombëtare“, është përcaktuar që renta minerare që shkon për njësitë e qeverisjes vendore ( niveli ligjor maksimal i vlerësuar është 25 % e rentës së grumbulluar) do të shpërndahet sipas kërkesës së tyre dhe duke marrë parasysh

klauzolat e lidhura me realizimin e buxhetit të pakushtëzuar. Në këtë vit është përcaktuar se NJQV do të përfitojnë + 50 % për naftën dhe gazin dhe + 80 % për mineraret si rente minerare mbi transfertën ( buxhetin ) e pakushtëzuar pasi transfertat ( buxheti ) dhe renta të jenë barazuar.

Në Ligjin nr. 106/2014 “Për Buxhetin e vitit 2015”, datë 27.11.2014 dhe në Ligjin Nr. 157/2014, datë 27.11.2014: Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, janë bërë përmirësime dhe ndryshime si më poshtë :

#### **Pasqyrimi i ndryshimeve përkatëse të lidhura me rentën minerare në Ligjin aktual të mësipërm:**

Në pikën 4, të nenit 2, të ligjit, përqindja e rentës minerare për përmbajtjen e mineralit krom në nënproduktin mineralar vendoset të jetë në masën sa 2/3 e normës së rentës të përcaktuar në shtojcën nr. 2, të ligjit.

Ky propozim, i cili ka ardhur nga grupet e interesit, ka për qëllim nxitjen e investimeve direkte vendase dhe të huaja nëpërmjet rritjes së shkallës së përpunimit të këtij minerali në vend.

Në adresim të kërkesës së Shoqatës së Mineraleve të Shqipërisë për uljen e rentës minerale për mineralin e kromit

të përpunuar në vend, dhe me qëllim nxitjen e investimeve direkte vendase dhe të huaja, nëpërmjet rritjes së shkallës së përpunimit të këtij minerali në vend, është vlerësuar që përqindja e rentës minerare për përmbajtjen e mineralit krom në nënproduktin mineralar të jetë në masën sa 2/3 e normës së rentës së mineralit. Aktualisht, struktura e eksportit të kromit mbizotërohet nga minerali i papërpunuar, ku pesha specifike e mineralit të papërpunuar të kromit zë rreth 91% (koncentrati i kromit dhe ferrokromi zënë në total rreth 9%). Rritja e shkallës së përpunimit të këtij minerali në vend, që vjen si pasojë e uljes së masës me 1/3 e normës së rentës, pritet të sjellë ndryshimin e të ardhurave të arkëtueshme nga renta minerare. Megjithatë efektet negative që do të sjellë kjo masë në të ardhurat nga renta në masën 45.3 milionë lekë, efektet pozitive të pritshme nga ulja e rentës minerare të nënprodukteve të kromit janë më të larta në drejtim të inkurajimit të investimeve në industri përpunuese; rritjes së furnizimit me lëndë të parë në vend, kundrejt eksportit, rritjes së investimeve kapitale në vend apo stimulit të vendeve të reja të punës. Duke iu referuar të dhënave të vitit 2013, ku arkëtimet nga renta minerare për koncentratin e kromit dhe ferrokromit ishin rreth 136 milionë lekë, efekti në të ardhurat e buxhetit të shtetit për vitin 2015 vlerësohet të jetë afërsisht minus 45.3 milionë lekë.

Në nenin 2 të ligjit, vlerësohet që të



ndryshojë përqindja e të ardhurave nga renta minerare që merr pushteti vendor ku zhvillohet veprimtaria minerare, nga 25% në 5%. Ky ndryshim ligjor shoqërohet dhe siguron përputhshmëri edhe me ligjin që miraton buxheti i shtetit 2015, sipas të cilit marrja e rentës minerare nga pushteti vendor nuk do të jetë më e lidhur me shumicën e transfertës së pakushtëzuar. Si rrjedhojë e ndryshimeve në kë këto dy ligje, bazuar në të ardhurat nga renta minerale për vitin 2013, të cilat vlerësohen rreth 7.8 miliard lekë për vitin 2015, pushtetit vendor do ti kalojnë rreth 400 milionë lekë nga 100 milionë lekë, që bashkitë dhe komunat kanë marrë në vitin 2013. *Ndarja e të ardhurave nga renta minerare midis pushtetit vendorë dhe qendror përbën një politikë normale fiskale të decentralizimit fiskal.* Mirëpo, për këtë ndarje të ardhurash midis dy pushteteve, ka dy ligje specifike të cilat përcaktojnë procedurën e shpërndarjes dhe që në dualizëm me njëra-tjetrën kanë bërë që, “de facto”, shumë pak rentë të marrë pushteti vendor.

Në bazë të ligjit të taksave kombëtare, 25% e të ardhurave nga renta minerale i jepet bashkive dhe komunave. Por bashkitë dhe komunat nuk marrin, sipas këtij ligji, 25% të të ardhurave nga renta, sepse në ligjin e buxhetit të shtetit është kufizuar marrja e kësaj rente nga bashkitë dhe komunat, duke e lidhur me shumën e transfertës së pakushtëzuar.

Me poshtë janë pikat dhe paragrafët që ndryshohen me ligjin Nr. 157/2014

Në pikën 4, paragrafi i parë, bëhen këto ndryshime:

a) Pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Përqindja e rentës minerare për përmbajtjen e mineralit metalor në nënproduktin minerar është në masën sa 2/3 e normës së rentës së përcaktuar në shtojcën nr. 2, “Grupi i parë (I) Mineralet metalike” që i bashkëlidhet këtij ligji.”

b) Fjalia e fundit ndryshohet si më poshtë:

“5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria. Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore.”

b. Udhëzime të Ministrisë së Financave.

Udhëzim Ministrisë së Financave Nr. 2, datë 17.01.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 26, datë

4.9.2008 “Për Taksat Kombëtare”, të ndryshuar.

Në Udhëzimin Nr. 26, datë 04.09.2008

“Për taksat kombëtare” të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme.

3. Pikat e mëposhtme ndryshohen me këtë përmbajtje:

“2.4.2. Kur zotëruesi i lejes së shfrytëzimit shetë për konsum final brenda vendit mineralin apo nënproduktin e prodhuar prej tij, ai paguan taksën e rentës minerare në bankën e nivelit të dytë për llogari të drejtorisë rajonale ku është regjistruar për të gjithë sasinë e shitur.

“2.4.6 Pjesa e të ardhurave nga renta minerare, që u takon njësitë të qeverisjes

vendore (përfshirë edhe ato të naftës sipas pikës 2.4.5), shpërndahet nga strukturat përgjegjëse të buxhetit në Ministrinë e Financave, sipas kriterëve ligjore të përcaktuara në aneksin nr. 1 të ligjit nr. 185/2013, datë 28.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”. Sipas këtij aneksi, njësitë e qeverisjes vendore përfitojnë + 50%, për naftën dhe gazin dhe + 80 % për mineraret, si rentë minerare mbi transfertën e pakushtëzuar pasi transferta dhe renta të jenë barazuar”.

Udhëzim Ministrisë së Financave Nr. 2/1, datë 12.3.2014 “Për një ndryshim në Udhëzimin Nr. 26, datë 4.9.2008 “Për Taksat Kombëtare”, Të ndryshuar

Në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008 “Për Taksat Kombëtare”, të ndryshuar, në pikën II të pikës 2.4.1, paragrafi i tretë dhe i katërt zëvendësohen nga paragrafët me këtë përmbajtje:

“Në momentin kur subjekti eksportues, eksporton mineralin që ka blerë nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit apo nënproduktin mineral, ai paguan rentën minerare vetëm për diferencën ndërmjet vlerës së rentës së përlllogaritur në bazë të çmimeve të eksportit, që është çmimi FOB në Shqipëri, dhe vlerës së rentës të paguar nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit në përputhje me pikën 3 të vendimit nr. 7, datë 4.1.2012 “Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare”.

Në momentin e eksportit në degën doganore, në bazë të deklaratës së eksportit dhe dokumentacionit shoqërues, përlogaritet vlera e plotë dhe shuma e rentës minerare për sasinë e mineralit apo nënproduktit që po eksportohet. Subjekti deklarues është i detyruar që në momentin e eksportimit, pranë organit doganor të vetëdeklaroj shumën e rentës minerare të paguar (pranë organeve tatimore) për sasinë e materialit apo nënproduktit që eksportohet, si dhe të depozitojë dokumentet përkatëse. Shuma që do të paguhet në doganë, do të jetë diferenca ndërmjet shumës së llogaritur për vlerën e plotë të rentës dhe shumës së rentës së vetëdeklaruar si të paguar pranë organeve tatimore. Organet tatimore, në bazë të të dhënave që marrin nga organet doganore, verifikojnë saktësinë e vetëdeklarimeve të bëra nga subjektet eksportuese dhe marrin masa për rregullimin e situatës në rast konstatimi të diferencave, si dhe njoftojnë organet doganore.”

c. Përqindja e rentës sipas klasifikimit për Sektorin Hidrokarbur :

a. Grupi III

○ Qymyret, bitumet dhe rërat bituminoze është 5 %  
 ○ Reshpet naftore është 5 %  
 ○ Pirobitumet është 6 %

b. Grupi VII ○ Nafta dhe Gazi është 10 %

Kontributi i rentës minerare nga zonat e industrisë nxjerrëse

|                                          | viti 2012 | viti 2013           |
|------------------------------------------|-----------|---------------------|
| Renta Minerare e grumbulluar nga Buxheti | 7.150.00  | 7.770.00 mijë lekë  |
| Renta Minerare e shpërndar nga Buxheti   | 41.790,1  | 100.659,2 mijë lekë |
| Përfitimi NJQV në %                      | 0.58      | 1.29                |

Kontributi industrisë nxjerrëse në ekonominë Shqiptare

|                                         | VITI 2011   | VITI 2012 (MILIARD LEKË) |
|-----------------------------------------|-------------|--------------------------|
| <b>Prodhimi total</b>                   | <b>70.7</b> | <b>65.8</b>              |
| Prodhimi naftës dhe gazit               | 47.9        | 50.3                     |
| Prodhimi minerar                        | 22.8        | 15.5                     |
| <b>Kontributi në PBB</b>                | <b>4.3%</b> | <b>5.6%</b>              |
| <b>Kontributi në Buxhetin e Shtetit</b> | <b>1.8%</b> | <b>2.5%</b>              |

Në vitin 2012, transferimet për rentën minerare arritën në shumën 41.790 mijë lekë që përbën 0.58 % të rentës së mbledhur në total ose 2.3 % të totalit të rentës së transferueshme në përputhje me Ligjin për Taksat Kombëtare. Në vitet pasardhëse ky nivel është rritur. Sipas Ministrisë së Financave, të ardhurat nga renta minerare në vitin 2011 dhe 2012 ishin regjistruar në Buxhetin e Shtetit në grup dhe nuk janë mbajtur regjistrime të sakta mbi rentën e gjeneruar nga secila NJQV, gje që për vitin 2013 dhe në vijim po përmirësohet. Bazuar në ligjin e buxhetit, shpërndarja e rentës minerare çdo vit vlerësohet mbi disa kritere ku kryesore janë:

○ Renta minerare u alokohet njësive vendore sipas kërkesës së tyre.

○ Njësitë e qeverisjes vendore përfitojnë +50% rentë minerare mbi transfertën e pakushtëzuar pasi transfertat dhe renta janë barazuar.

Në këtë mënyrë pasqyrohet njëkohësisht edhe nxitja për njësitë e qeverisjes vendore që të ndjekin, grumbullojnë dhe rakordojnë të dhënat për realizimin e fondeve të rentës minerare në nivelet e parashikuara 4 mujore e vjetore sipas buxhetit të pakushtëzuar dhe ta kërkojnë atë për qeverisjen vendore kur realizohet apo tejkalohet ky fond.

## Tabela1

Krahasimi i fondit  
buxhetor i  
qeverisjes vendore  
me fondet e dhëna  
nga renta minerare

| Emërtimi                                                                                                                                                | Viti 2012 | Viti 2013 | Viti 2014 | Viti 2015 |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| <b>Fonde buxhetore shtese te dhëna me shpërndarjen e rentës minerare</b>                                                                                |           |           |           |           |
| Fonde te rentës minerare industrive nxjerrëse e grumbulluar nga buxheti gjithsej                                                                        | 7.150.000 | 7.770.000 | 7.300.000 |           |
| Nga zonat hidrokarbure                                                                                                                                  | 6.420.000 | 6.950.000 | 5.500.000 |           |
| Nga zonat minerare                                                                                                                                      | 730.000   | 820.000   | 1.800.000 |           |
| Fonde te rentës minerare industrive nxjerrëse e shpërndarë nga buxheti gjithsej                                                                         | 41.790,1  | 100.659,2 |           |           |
| Për zonat hidrokarbure                                                                                                                                  | 41.790,1  | 100.659,2 |           |           |
| Për zonat minerare                                                                                                                                      | 0         | 0         |           |           |
| Niveli fondeve te rentës shpërndara kundrejt totalit te rentës se transferueshme ( grumbulluar )ne % ( ligji përcakton max. 25 % te rentës grumbulluar) | 0.58      | 1.30      |           |           |
| <b>Bashkia Patos</b>                                                                                                                                    |           |           |           |           |
| Buxheti i dhënë nga shteti ne vite                                                                                                                      | 80.312    | 71.477    | 84.876    | 89.119    |
| Fonde buxhetore shtese te dhëna me shpërndarjen e rentës minerare                                                                                       | 16.062    | 35.738    | 42.438    |           |
| Niveli I fondeve te rentës kundrejt fondit buxhetor ne %                                                                                                | 20        | 50        | 50        |           |
| <b>Komuna Mbrostar</b>                                                                                                                                  |           |           |           |           |
| Buxheti dhënë nga shteti ne vite                                                                                                                        | 21.238    | 21.805    | 25.023    | 13.385    |
| Fonde buxhetore shtese te dhëna me shpërndarjen e rentës minerare                                                                                       | 3.814     | 10.902    | 0         |           |
| Niveli i fondeve te rentës kundrejt fondit buxhetor te dhënë ne %                                                                                       | 18        | 50        | 0         |           |
|                                                                                                                                                         |           |           |           |           |

**Shënim:** Ministria e Finacave, të ardhurat nga renta minerare në vitin 2012 janë regjistruar në Buxhetin e Shtetit në grup dhe jo me regjistrime të sakta për çdo njësi të qeverisjes vendore (NJGV) mbi rentën minerare të gjeneruar nga çdo njësi vendore.

Për vitin 2011 nuk është shpërndarë ne NJQV fond i përfutur nga renta minerare

- Ligji Nr. 119/2012, date 17.12.2012 "Buxheti shtetit v. 2013"

- Ligji Nr. 204/2013, date 30.12.2013 "Buxheti shtetit v. 2014"

- Ligji Nr. 160/2014, date 27.11.2014 "Buxheti shtetit v. 2015"

Të dhëna V.2013 - 2015 nuk janë dhënë deri me dat. 23.6.2015

Ligji Nr. 10487, date 05.12.2011 "Buxheti shtetit v. 2012"

## Tabela 2

Njësi Vendore përfituese të rentës minerare  
në vitet 2012-2013

| Njësi Vendore<br>Përfituese                 | Renta minerare<br>e përfituar viti<br>2012 në Lekë |
|---------------------------------------------|----------------------------------------------------|
| <i>Fier</i>                                 | 37,843,100                                         |
| <b><i>Bashkia<br/>Patos</i></b>             | 16,062,400                                         |
| <i>Bashkia<br/>Roskovec</i>                 | 4,247,600                                          |
| <b><i>Komuna<br/>Mbrostar</i></b>           | 3,814,000                                          |
| <i>Komuna<br/>Portez</i>                    | 4,179,000                                          |
| <i>Komuna<br/>Ruzhdie</i>                   | 448,500                                            |
| <i>Komuna<br/>Zharez</i>                    | 3,024,600                                          |
| <i>Komuna<br/>Kuman</i>                     | 3,456,800                                          |
| <i>Komuna<br/>Bubullime</i>                 | 2,610,200                                          |
| <i>Vlore</i>                                | 3,947,000                                          |
| <i>Komuna<br/>Vllahinë</i>                  | 3,947,000                                          |
| <b><i>GJITHSEJ</i></b>                      | 41,790,100                                         |
| <b><i>Zonat e<br/>naftës,<br/>gazit</i></b> | 41,790,100                                         |
| <b><i>Zonat<br/>minerare</i></b>            | 0                                                  |

| Njësi Vendore<br>Përfituese             | Renta minerare e<br>përfituar viti 2013 në<br>Lekë |
|-----------------------------------------|----------------------------------------------------|
| <i>Fier</i>                             | 91,772,146                                         |
| <b><i>Bashkia Patos</i></b>             | 35,738,000                                         |
| <i>Bashkia Roskovec</i>                 | 9,450,806                                          |
| <b><i>Komuna Mbrostar</i></b>           | 10,902,000                                         |
| <i>Komuna Portez</i>                    | 11,687,500                                         |
| <i>Komuna Zharez</i>                    | 7,606,958                                          |
| <i>Komuna Kuman</i>                     | 8,229,882                                          |
| <i>Komuna Bubullime</i>                 | 8,157,000                                          |
| <i>Vlore</i>                            | 8,887,096                                          |
| <i>Komuna Vllahinë</i>                  | 8,887,096                                          |
| <b><i>GJITHSEJ</i></b>                  | 100,659,242                                        |
| <b><i>Zonat e naftës,<br/>gazit</i></b> | 100,659,242                                        |
| <b><i>Zonat minerare</i></b>            | 0                                                  |

| Emri                                                                                                                                  | Shuma          | Përdorimi      | Përfitimi i komunitetit                                                                                                                                |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|----------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Financimi nga Buxheti Shtetit me fonde të përfituara nga renta minerare</b>                                                        | <b>94,238</b>  | <b>94,238</b>  |                                                                                                                                                        |
| Viti 2012                                                                                                                             | <b>16,062</b>  | <b>16,062</b>  |                                                                                                                                                        |
| Viti 2013                                                                                                                             | <b>35,738</b>  | <b>35,738</b>  |                                                                                                                                                        |
| Viti 2014                                                                                                                             | <b>42,438</b>  | <b>42,438</b>  |                                                                                                                                                        |
| <b>Financimi nga donatore të sektorit industrisë nxjerrëse</b>                                                                        |                | 12,900         |                                                                                                                                                        |
| <b>Përdorimi fondit</b>                                                                                                               |                |                |                                                                                                                                                        |
| nga buxheti                                                                                                                           |                |                |                                                                                                                                                        |
| nga donoret e sektorit industrisë nxjerrëse                                                                                           |                | 12,900         |                                                                                                                                                        |
| <b>Përdorimi fondit për projekte dhe aktivitete të detajuara (Projektet e realizuara nga fondet e përfituara nga renta minerare).</b> |                | <b>94,238</b>  |                                                                                                                                                        |
| Rikonstruksioni Rrugës Sotir Xoxe                                                                                                     |                | <b>42,163</b>  |                                                                                                                                                        |
| Rikonstruksioni Rrugës Dhorë Tanaka                                                                                                   |                | <b>35,537</b>  |                                                                                                                                                        |
| Rikonstruksioni Rrugës Franc Nopca                                                                                                    |                | <b>16,341</b>  |                                                                                                                                                        |
| Hidroizolimi Çerdhe                                                                                                                   |                | <b>197</b>     |                                                                                                                                                        |
| <b>Projekte të miratuara për përdorim fondesh nga renta</b>                                                                           | <b>107,138</b> | <b>107,138</b> |                                                                                                                                                        |
| nga Këshilli Bashkiak                                                                                                                 | <b>107,138</b> | <b>94,238</b>  |                                                                                                                                                        |
| nga Bashkia                                                                                                                           |                | <b>12,900</b>  |                                                                                                                                                        |
| <b>Bashkëpunim për këto fonde me projekte dhe financime të tjera të detajuara</b>                                                     |                |                | -                                                                                                                                                      |
| <b>Monitorimi projekteve është kryer</b>                                                                                              |                |                |                                                                                                                                                        |
| nga individë specialiste                                                                                                              |                |                |                                                                                                                                                        |
| staf specialistesh                                                                                                                    |                |                |                                                                                                                                                        |
| ne bashkëpunim me përfaqësues të komunitetit                                                                                          |                |                |                                                                                                                                                        |
| <b>Relacioni përfundimtar</b>                                                                                                         |                |                |                                                                                                                                                        |
| Përfitimi I arritur                                                                                                                   |                |                |                                                                                                                                                        |
| Përfitimi I komunitetit                                                                                                               |                |                | Mbi 10,000 banorë                                                                                                                                      |
| Publikimi I punës së kryer dhe përfitimit të arritur                                                                                  |                |                |                                                                                                                                                        |
| Vazhdimësia e projektit ( gjendja aktuale )                                                                                           |                | Përfunduar     |                                                                                                                                                        |
| Foto të mundshme                                                                                                                      |                |                |                                                                                                                                                        |
| <b>Projekte e propozime të kërkuara në vijim</b>                                                                                      |                | 4,200          |                                                                                                                                                        |
| Ndërtim Lulishte Meleq Gostinishti                                                                                                    |                | 4,200          |                                                                                                                                                        |
| <b>Propozime dhe sugjerime përmirësuese</b>                                                                                           |                |                |                                                                                                                                                        |
| për legjislacionin në fuqi                                                                                                            |                |                | Të përmirësohet legjislacioni në fuqi duke bërë që pushteti vendor të përfitojë më shumë nga pushteti qendror sepse burimet minerare janë në këtë zonë |
| për procedurat e financimit, raportimit për bashkëpunimin me                                                                          |                |                |                                                                                                                                                        |
| - institucionet shtetërore qendrore e vendore                                                                                         |                |                |                                                                                                                                                        |
| - shoqërinë civile                                                                                                                    |                |                |                                                                                                                                                        |
| - grupet e interesit                                                                                                                  |                |                |                                                                                                                                                        |
| - të tjerë                                                                                                                            |                |                |                                                                                                                                                        |

## Tabela 3

Bashkia Patos Informacione e të dhëna të raportuara nga Bashkia Patos lidhur me përdorimin e të ardhurave të marra nga renta minerare në vite

## Tabela 4

Informacione e të dhëna të raportuara nga Komuna Mbrostar Fier lidhur me përdorimin e të ardhurave të marra nga renta minerare në vite

| emërtimi                                                                                                                              | shuma         | përdorimi     | përfitim i komunitetit                             |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------|---------------|----------------------------------------------------|
| <b>Financimi nga Buxheti Shtetit me fonde te përfituara nga renta minerare</b>                                                        | 14,716,000    | 14,716,000    |                                                    |
| Viti 2012                                                                                                                             | 3,814,000     | 3,814,000     | Pagesa energjisë elektrike,<br>Pompat ujit pijshëm |
| Viti 2013                                                                                                                             | 10,902,000    | 10,902,000    | Investime ne projekte te ndryshme                  |
| Viti 2014                                                                                                                             | s'ka          |               |                                                    |
| <b>Financimi nga donatore te sektorit industrisë nxjerrëse</b>                                                                        |               |               |                                                    |
| <b>Nga kompania Bankers Petroleum</b>                                                                                                 | 16,000,000.00 | 16,000,000.00 |                                                    |
| Ambulance ne fshatin Kallm i Madh                                                                                                     | 4,000,000     | 4,000,000     | Komuniteti ne fshatin Kallm i Madh                 |
| Pus për ujë te pijshëm ne fshatin Vajkan                                                                                              | 4,000,000     | 4,000,000     | Fshatrat Vajkan, Verri dhe Kallm                   |
| Kënd sportiv, Shkolla 9-vjeçare Kallm i Vogël                                                                                         | 4,000,000     | 4,000,000     | Nxënësit e shkollës Kallm i Vogël                  |
| Rehabilitim i sistemit te ujitjes,                                                                                                    |               |               |                                                    |
| Kallm i Madh dhe Kallmi Vogël                                                                                                         | 4,000,000     | 4,000,000     | Fermerët e këtyre fshatrave                        |
| <b>Përdorimi fondit për projekte dhe aktivitete te detajuara (Projektet e realizuara nga fondet e përfituara nga renta minerare).</b> |               |               |                                                    |
| <b>Renta minerare e vitit 2013, e ndare si me poshtë</b>                                                                              | 10,902,000    | 10,902,000    |                                                    |
| Shpim pusi uji te pijshëm                                                                                                             |               | 2,501,000     | Përfitoi fshati Mbrostar-Ura                       |
| Vendosje kosha për plehrat                                                                                                            |               | 440,000       | Ne te gjitha fshatrat                              |
| Hidroizolimi i shkollës Vajkan                                                                                                        |               | 574,162       | Komuniteti Vajkan                                  |
| Rrethimi dhe sistemimi i varrezave te fshatrave                                                                                       |               | 3,600,000     | Komuniteti                                         |
| Blerje pajisje për shkollat e fshatrave                                                                                               |               | 285,000       | Nxënësit e shkollave                               |
| Rikonstruksione ne rrugët e brend. te fshatrave                                                                                       |               | 3,501,838     | Rregullimi i jetës ne komunitet                    |
| <b>Projekte te miratuara për përdorim fondesh nga renta nga Këshilli Bashkiak nga Bashkia</b>                                         |               |               |                                                    |
| <b>Bashkëpunim për këto fonde me projekte dhe financime te tjera te detajuara te tjera te detajuara</b>                               |               |               |                                                    |
| <b>Monitorimi projekteve është kryer nga individë specialiste staf specialistesh ne bashkëpunim me përfaqësues te komunitetit</b>     |               |               |                                                    |
| <b>Relacioni përfundimtar</b>                                                                                                         |               |               |                                                    |
| Përfitimi I arritur                                                                                                                   |               |               |                                                    |
| Përfitimi I komunitetit                                                                                                               |               |               |                                                    |
| Publikimi I punës se kryer dhe përfitimit te arritur                                                                                  |               |               |                                                    |
| Vazhdimësia e projektit ( gjendja aktuale )                                                                                           |               |               |                                                    |
| Foto te mundshme                                                                                                                      |               |               |                                                    |
| <b>Projekte e propozime te kërkuara ne vijim</b>                                                                                      |               |               |                                                    |
| Rruge rurale Mbrostar-Kallm Madh-Kallm i Vogël                                                                                        | 260,000,000   |               |                                                    |
| Rikonstruksion ujësjellësi rajonal Verri-Kallm                                                                                        | 27,000,000    |               |                                                    |
| Rruge dytësore ne parcelat bujqësore                                                                                                  | 75,000,000    |               |                                                    |
| <b>Propozime dhe sugjerime përmirësuese</b>                                                                                           |               |               |                                                    |
| për legjislacionin ne fuqi                                                                                                            |               |               |                                                    |
| për procedurat e financimit, raportimit                                                                                               |               |               |                                                    |
| për bashkëpunimin me                                                                                                                  |               |               |                                                    |
| - institucionet shtetërore qendrore e vendore                                                                                         |               |               |                                                    |
| - shoqërinë civile                                                                                                                    |               |               |                                                    |
| - grupet e interesit                                                                                                                  |               |               |                                                    |
| - te tjerë                                                                                                                            |               |               |                                                    |

## Kontrolli

---

### Kontrolli i përdorimit të fondeve të përfituara nga renta minerare, dhënë për Bashkinë Patos me destinacion realizimin e projekteve për komunitetin.

1. Në bazë të raportimeve dhe dokumentacionit përkatës në Bashkinë Patos, përdorimi i fondeve të dhëna nga buxheti qëndror të përfituara nga renta minerare, ka qënë konform destinacionit dhe vendimeve përkatëse në organet drejtuese vendore:

- Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr. 6, datë 01.02.2012

( Pasqyra Nr. 5 – Investimet Kapitale v. 2012 sipas programeve dhe burimeve të financimit), miratuar nga Prefektura me shkresë Nr. 76/1, datë 15.02.2012

- Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr. 7, datë 22.01.2013

( Pasqyra Nr. 4 – Investimet Kapitale v. 2013 sipas programeve dhe burimeve të financimit), miratuar nga Prefektura me shkresë Nr. 84/1, datë 31.03.2013 Vendimi Këshillit Bashkiak Nr. 8, datë 25.02.2014

( Pasqyra Nr. 4 – Investimet Kapitale v. 2014 sipas programeve dhe burimeve të financimit), miratuar nga Prefektura me shkresë Nr. 293/1, datë 03.03.2014 Tabela 3 dhe 4 pasqyrojnë destinacionin e përdorimit të tyre në Bashkinë Patos dhe Komunën Mbrostar.

2. Në këtë drejtim është ushtruar kontroll nga KLSH, i cili në raportin e tij ka relatuar lidhur me objektet e financuara me fondet buxhetore shtesë nga të ardhurat e rentës minerare.

## KLSH

---

Mbi Auditimin Financiar të Ushtruar në Bashkinë Patos, Qarku Fier Raporti Përfundimtar i Auditimit Financiar të kryer në Bashkinë Patos, Qarku Fier, me objekt:

“Auditimi i llogarive vjetore të administratës së institucionit, auditimi i zonave të llogarisë, krijimi dhe përdorimi i të ardhurave, menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm etj.”, lloji i auditimit: “Auditim financiar për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 31.12.2012 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 117, datë 06.09.2013. Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, i ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, KLSH me shkresën nr. 559/8, datë 06.09.2013, i ka rekomanduar Znj. Rajmonda Balilaj, Kryetare e Bashkisë Patos, Qarku i Fierit, zbatimin e masave të mëposhtme.

Autoriteti Kontraktor, duhet të monitorojë zbatimin e kontratës ose lëvrimet, për t’u siguruar nëse cilësia e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe për hyrjet që bëhen, duhet të kontrollojë në se fletëhyrja ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës sipas kërkesave të VKM nr. 1, dt.10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” kreu VIII, pika 2/b dhe Urdhër të Ministrisë së Financave nr. 54, datë 15.7.2010 “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Urdhër të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik ”.

### Masa dëmshpërblimi

Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “ Kodi i procedurave administrative”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, nga Bashkia Patos të nxirren aktet administrative, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen ndalesat në vlerën 26,756,922 lekë si më poshtë:

Për operatorin “X” sh.p.k në vlerën 3,128,107 lekë, si detyrim gjorbë për tejkalim të afateve të realizimit të kontratës, pasi në tenderin “Rikonstruksioni i rrugës Dhorë Tanaka” për periudhën nga data 18 tetor 2012 deri 11 janar 2013 (85 ditë) nuk ka amendament shtesë kontratë për shtyrjen e afatit të punimeve.

- Për operatorin ekonomik kontaktues “X” sh.p.k. & “Y” sh.p.k” Tiranë përfaqësuar në këtë kontratë nga “X” sh.p.k. Tiranë, në vlerën

640,548 lekë, pasi nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolauditimit të punimeve të ndërtimit me objekt

“Rikonstruktion i rrugës Sotir Xoxe” rezultojnë diferenca në volume punësh të pakryera dhe përfitim të padrejtë. H.A, mbikëqyrës i punimeve të ndërtimit

- Për punimet e ndërtimit me objekt

“Rikonstrukcioni i rrugës “ Franc Nopça Patos”, është hartuar një amendament kontrate nr. 1136/5, datë 26.10.2012 sipas kërkesës së mbikëqyrësit të punimeve A. D me nr. 13, datë 6.11.2012 i cili zgjat afatin e punimeve për realizimin e punimeve shtesë me 30 ditë kalendarike si rezultat i lindjes së punimeve të paparashikuara në objektin

“Rikonstrukcioni i rrugës Franc Nopça” të cilat sipas kontratës bazë nr. 606/10, datë 6.8.2012 me afat 45 ditor duhej të përfundonin në datën 19 shtator 2012 dhe sipas këtij amendamenti përfundimi i punimeve shtyhet deri datën 18 tetor 2012.

Nga auditimi i dosjes së zbatimit të punimeve të ndërtimit rezulton se: Njoftimi për fillimin e punimeve sipas procesverbalit të mbikëqyrësit të punimeve është data 13 gusht 2012 dhe Procesverbali i përfundimit të punimeve është i datës 11.01.2013 i mbajtur nga mbikëqyrësi i punimeve A.B, dhe sipërmarrësi S.P, kurse akti i marrjes në dorëzim të objektit është i datës 4.02.2012. Nuk ka asnjë amendament kontratë për shtyrjen e afatit të punimeve të ndërtimit nga data 18 tetor 2012 deri në datën 11 janar 2013, kohë kur kanë përfunduar punimet sipas njoftimit dhe procesverbalit i datës 11.01.2013 i mbajtur nga mbikëqyrësi i punimeve A.B. 3. Rekomandimet e dhëna nga KLSH janë ndjekur nga Bashkia Patos.

## KONKLUZIONE

**1** Shperndarja e rentës minerare për periudhen 2012 – 2013 është bere ne përputhje me ligjin e buxhetit dhe te taksave kombëtare por rezulton se kane përfituar vetëm NJQV ne zonat nafte e gaz mbajtëse.

**2** NJQV e Bashkisë Patos dhe Komunës Mbrostar ka kërkuar fondin përkatës ne Ministrinë e Financave mbi bazën e projekteve dhe me destinacion ne përmirësimin e jetesës se komunitetit por MF nuk ka bere analize dhe ndarje te sakte te fondeve te grumbulluara nga renta minerare dhe te shpërndara ne baze te realizimit te transfertës se pakushtëzuar për njësite përfituese ne zonat minerare dhe naftëmbajtëse.

**3** Financimi i projekteve ne Bashkinë Patos dhe Komunën Mbrostar është bere me miratim te organeve drejtuese te NJQV

**4** Kontrolli dhe auditimi ligjor i përdorimit te fondeve nga te ardhurat e rentës minerare me destinacion ne Bashkinë Patos për v. 2012 është bere nga strukturat e KLSH, i cili ka lënë detyra dhe rekomanduar masa përkatëse deri ne dëmshpërblim nga personat përgjegjës.

**5** Nevojat dhe kërkesat e NJQV te Bashkisë Patos për fonde nga te ardhurat e krijuara nga renta minerare kane qene me te larta se fakti qe është realizuar për vitin 2012 dhe 2013.

**6** Mbështetje financiare për projekte ne ndihme te komuniteteve kane dhënë dhe subjektet e licencuara ne zone por niveli i evidentimit, kontrollit, raportimit dhe rakordimit te tyre te detajuar tekniko – ekonomik kërkon te rritet shume me tepër ( fondet e dhëna, kompanitë mbështetëse, miratimet e dhëna nga AKBN për fondet e përdorura ne NJQV dhënë nga kompanitë hidrokarbure, periudha e financimit, projektet e zbatimit, çmimet e materialeve te përdorura ose çmimet për njësi sipërfaqe punimesh, etj.).

**7** Për / në objektet e ndërtuara ose rikonstruktura ne Bashkinë Patos dhe NJQV afër saj, me fondet e përfituara prej rentës minerare ka patur shume pak njoftime dhe publicitet njohës se ato janë bere me këto lloj fondesh dhënë nga Ministria e Financave. Po e njëjta gjë mund te thuhet edhe ne ato raste kur mbështetja ka ardhur nga subjektet e licencuara te zonës ( si p.sh. Bankers Petroleum ).

**8** NJQV Bashkia Patos ka diskutuar dhe kërkuar ( vitet 2012 – 2014 ) qe renta minerare te jete e transferueshme drejtpërdrejt ne njësitë vendore dhe jo me baze kufizimet artificiale te vendosura ne ligjin e buxhetit te shtetit.

Faktikisht rezultatet tregojnë se NJQV kane marre shume pak fonde kundrejt nivelit te fondeve te krijuara nga renta minerare.

**9** NJQV Bashkia Patos ka diskutuar dhe kërkuar ( viti 2015 ) qe renta minerare te jete e transferueshme drejtpërdrejt ne njësitë vendore ne një nivel me te larte se 5 % kundrejt miratimit te bere ne Ligjin Nr. 157/2014 “ Për disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin Nr. 9975, date 28.07.2008 “ Për Taksat Kombëtare” te ndryshuar”.

## REKOMANDIME

**1** Ministria e Financave dhe Pushteti Vendor duhet të hartojë *data- base* për evidentimin e fondit të grumbulluar nga renta minerare sipas ndarjes së re administrative dhe për çdo NJQV duke rakorduar me AKBN – Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (Ministria Energjisë dhe Industrisë) mbi bazën e sipërfaqeve që përdoren dhe të dhëna në licencat e subjekteve të industrisë nxjerrëse.

**2** NJQV duhet të evidentojnë projektet dhe kërkesat financiare në mbështetje të komunitetit si dhe ti argumentojnë ato në strukturat drejtuese dhe në Ministrinë e Financave duke përfshirë paraqitjen e projekteve përkatëse në aspektin teknik – ekonomik - social të tyre.

**3** . NJQV duhet të evidentojnë fondet e krijuara nga renta minerare dhe rakordojnë me Ministrinë e Financës

shpërndarjen e tyre me qëllim përfitimi të komunitetit sipas projekteve dhe kërkesave te paraqitura

**4** NJQV kërkojnë më tepër bashkëpunim, rakordim dhe ndihmë në hartimin e projekteve të evidentuara në prioritetet e zonave sëbashku me specialistët e pushtetit qendror, shoqëritë civile të zonës dhe të kompanive e grupeve të interesit me qëllim arritjen e objektivave në përmirësim të vazhdueshëm të nivelit të jetesës së komunitetit e tregues të tjerë në këto zona të industrisë nxjerrëse.

**5** Të përfshihet në raportet e ardhshme EITI një pikë ku të pasqyrohet shpërndarja e fondeve të krijuara nga renta minerare dhe destinacioni i përdorimit të tyre në NJQV, përfitimi i komunitetit prej tyre si dhe probleme te tjera te lidhura me përdorimin dhe efektin e përdorimit te këtyre fondeve ne komunitetin e zonës përkatëse etj

## GRUPI PUNËS

**Ky raport është hartuar dhe redaktuar nga Sekretariati Shqiptar EITI. Agim Shehu, Koordinator dhe Lluka Gjergo, Koordinator në Sekretariatin Shqiptar EITI kanë kryer kërkime, intervista dhe konsultime gjatë gjithë raportit. Falenderime i detyrohem institucioneve të cilat kanë ndihmuar në analizën e këtij raporti si Ministrinë e Financave, Drejtoria e Buxhetit, Bashkia Patos, Komuna Mbrostar.**



## FOTO

Faza përfundimtare në objektet e financuara nga fondet e rentës minerare në Bashkinë Patos

Rruga "Sotir Xoxe"  
-Gjatesia e rruges 1100m  
-Gjerësia e rruges 6m  
-Trotuar me gjerësi 1.5m  
-Elemente të gjelbërimit dhe të ndricimit  
-Numri i përfituesve 6000 banorë



Rruga "Sotir Xoxe"  
-Gjatesia e rruges 1300m  
-Gjerësia e rruges 6m  
-Trotuar me gjerësi 1.5m  
-Elemente të gjelbërimit dhe të ndricimit  
-Numri i përfituesve 10000 banorë




Rruga "Dhori Tanaka"  
-Gjatesia e rruges 1100m  
-Gjerësia e rruges 6m  
-Trotuar me gjerësi 1.5m  
-Elemente të gjelbërimit dhe të ndricimit  
-Numri i përfituesve 6000 banorë




## FOTO

Faza përfundimtare në objektet e  
finacuara nga fondet e rentës minerare në  
Bashkinë Patos



## FOTO

Faza e ndërtimit në objektet e finacuara nga fondet e rentës minerare në Bashkinë Patos



Sekretariati  
Shqiptar EITI



Ky punim u mbështet nga Fondi Shumëdonator i Mbështetjes Programatike Globale për Industrinë Nxjerrëse (EGPS), i administruar nga Banka Botërore. Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë punim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bankës Botërore, Bordit të Drejtorëve Ekzekutivë të saj apo qeverive që ata përfaqësojnë.